



1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur

DATA	Tërheqje likuiditeti		
	REPO njëjavore	REPO mujore	REPO tremujore
06.04.2006	3,908.00		
13.04.2006	4,735.00		1,500.00
20.04.2006	1,985.00		850.00
27.04.2006	757.00		
04.05.2006	1,680.00		
11.05.2006	6,100.00		
18.05.2006	2,530.00		700.00
25.05.2006	2,205.00		
01.06.2006	3,630.00		
08.06.2006	6,140.00	2,000.00	
15.06.2006	4,745.00		
22.06.2006	490.00		
29.06.2006	2,371.00		

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

interesat e tregjeve, Banka e Shqipërisë, sikurse në tremujorin e parë, krahas instrumentit kryesor të tregut (*marrëveshje riblerjeje me maturim javor*) përdori edhe instrumentet rregullues, *marrëveshjet e riblerjes me maturim mujor dhe tremujor*. Likuiditeti i tërhequr nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me maturim tremujor ishte 3.05 miliardë lekë, ndërsa me marrëveshje mujore riblerjeje u tërhoqën 2 miliardë lekë. Në bazë javore, Banka e Shqipërisë tërhoqi mesatarisht 3.2 miliardë lekë nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor.

Gjendja e lartë e likuiditetit në sistemin bankar që ishte karakteristikë e tremujorit të dytë të vitit 2006 është stimuluar kryesisht nga likuiditeti i papërdorur i qeverisë kaluar në sistemin bankar nëpërmjet uljes së emetimit të bonove të thesarit në tregun primar dhe nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes midis Ministrisë së Financave dhe sistemit bankar. Duke marrë në konsideratë parashikimet për vazhdimin e gjendjes së tepricës së likuiditetit bazuar kjo edhe në parashikimin e qeverisë për gjendjen e buxhetit gjatë pjesë së parë të vitit, me qëllim zbutjen e presionit që po ushtronte kjo tepricë mbi


Krahas instrumenteve të përkohshme të menaxhimit të likuiditetit, me qëllim sterilizimin e likuiditetit të injektuar nëpërmjet blerjes së valutës në tregun valutor, Banka e Shqipërisë tërhoqi likuiditetet në mënyrë të përhershme, duke ulur investimin e saj në tregun primar të bonove të thesarit. Tërheqja e likuiditetit në këtë formë u realizua në javën e fundit të prillit në shumën 1 miliard lekë dhe në javën e dytë të muajit maj, në shumën 1.5 miliardë lekë.

1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Në mbështetje të ndërhyrjeve me instrumentet e tregut të hapur, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 307 milionë lekë në krahasim me 736 milionë lekë në tremujorin e kaluar. Në kushtet e tepricës së likuiditetit dhe plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë tremujorit të dytë të vitit 2006.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2006.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2006.



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Edhe gjatë tremujorit të dytë të këtij viti, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun e brendshëm valutor, duke blerë valutë nga bankat e nivelit

të dytë në funksion të përmbushjes së objektivit të Rezervës Ndërkombëtare Neto. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë kanë vazhduar të jenë në kahun e blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë. Si rezultat i ndërhyrjeve në tregun e brendshëm valutor, gjatë tremujorit të dytë, Banka e Shqipërisë ka shitur 2,850.21 milionë lekë.

2.2 Veprime të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i Qeverisë Shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm, ku pagesat e kryera gjatë tremujorit të dytë, llogariten në 1,909.77 milionë lekë.

Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave llogaritet në 3,816.54 milionë lekë dhe lidhet kryesisht me fondet e derdhura në favor të Qeverisë Shqiptare për privatizimin e Bankës Italo-Shqiptare. Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 37.30 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).